



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 14.02.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimeve për refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit për disa gjyqtarë, të propozuara nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:05 dhe mbaroi në orën 13:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i projektvendimeve për refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit për disa gjyqtarë, të propozuara nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit që jeni që të gjithë prezent këtu.

Sot po fillojmë mbledhjen e radhës, ku të gjithë anëtarët janë prezent në këtë mbledhje.

Falenderojmë edhe vëzhguesit që janë pjesëmarrës këtu, duke përfshirë Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe OSBE-në sepse dy misionet e tjera EURALIUS dhe USAID-i kanë qenë përherë pjesë e mbledhjeve tona të zhvilluara që nga momenti i parë dhe deri tani.

Për të vijuar me mbledhjen, kemi rendin e ditës, ku siç e keni përpara, janë parashikuar 3 çështje për shqyrtim në rendin e ditës. Çështja e parë ka të bëjë me “Miratimin e projektvendimeve për refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit për disa gjyqtarë, të propozuar kjo nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës”. Çështja e dytë është “Shqyrtimi i projektvendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë

tjetër”. Edhe ky projekt-akt është propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Dhe çështja e tretë është “Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Atëherë, nëse jemi dakord me rendin e ditës, vazhdojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me miratimin e projektvendimit për refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit. Ashtu sikurse jeni në dijëni, në mbledhjen e kaluar, Këshilli ka miratuar dy rregullore. Janë konkretisht Rregullorja “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” në të cilën është parashikuar dhe kërkohet që jo vetëm gjyqtari të shfaqë pëlqimin e tij për kandidimin për të shërbyer në skemën e delegimit, por ai duhet edhe të plotësojë disa kriteret në mënyrë që ai të përfshihet në këtë skemë delegimi.

Aktualisht, kanë shfaqur pëlqimin disa gjyqtarë për të qenë pjesë e skemës së delegimit, ndërkohë që në zbatim të nenit 9, pika 1 të kësaj Rregulloreje është parashikuar që Këshilli vendos për pranimin ose refuzimin e kandidaturës së gjyqtarit në skemën e delegimit, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Lidhur me kërkesat e paraqitura, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka propozuar refuzimin e kandidimit në këtë skemë delegimi, për disa gjyqtarë.

Për më tepër fjalën ia japim kryetarit të këtij Komisioni, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, në vijim edhe të fjalës së Kryetares, pas miratimit të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019 dhe thirrjes së bërë publikisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, adresuar gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor kanë mbërritur dhënia e pëlqimit apo kandidimi nga 4 (katër) gjyqtarë, të cilët kanë shprehur pëlqimin e tyre për t’u përfshirë në skemën e delegimit. Konkretisht janë zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat; zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë; zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat; edhe zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (*gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë*).

Ne kemi përgatitur për secilin nga kandidaturat e paraqitura një projektvendim, përmes së cilit kemi propozuar refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit, duke konsideruar kriteret që kemi miratuar në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, të miratuar me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019. Konkretisht për zotin {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, konstatohet se ka një shkak refuzimi, pikërisht ai është duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër në kushtet e transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Ky kriter përjashtues është i parashikuar në nenin 4, germa /f/ e Rregullores.

Ndërsa, sa i përket tre kandidatëve të tjerë, {...}, {...} dhe {...}, konstatohet një shkak refuzimi, pikërisht ai sipas germës /e/ të nenit 4 të Rregullores “Për skemën e delegimit...”, është cenimi i funksionalitetit të gjykatës ku ata ushtrojnë aktualisht funksionin.

Në këto kushte, sa kohë kemi miratuar kriteret për skemën e delegimit, kemi përgatitur edhe aktet refuzuese, për sa kohë nuk plotësojnë kriteret që ne kemi dakordësuar të gjithë së bashku. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë sugjerim nga anëtarët?

Maksim Qoku: Përshëndetje!

E nis fjalën aty ku e mbaroi kolegu: “Skema që kemi miratuar të gjithë së bashku”.

Të them, -kërkoj falje!

–Nuk e di, më ka kaluar.

Unë mendoj që pika /e/ e nenit 4 nuk qëndron. Mbase edhe e ftoj Këshillin që ta shohim. Gjykimi i Këshillit në lidhje me përcaktimin e kësaj pike, kam përshtypjen që është një farë disbalancimi në figurën e gjykatësit apo magjistratit dhe më tej duket se e vë në diskriminim, duke i bërë një ndarje midis faktit nëse ndodhet në një gjykatë të largët, me një organikë të pakët, organikë të vogël, e gjëra të kësaj natyre dhe më duket se qëndron si një parakusht pengues për aplikimin e nenit 45 në lidhje me skemën. Dhe këtë e kam thënë që neni 45 përcakton dy kushte kumulative, që është magjistrati të jetë të

paktën 1 vit dhe të jetë magjistrat dhe mund të kandidojë. Duke mos patur një kusht pengues pikërisht në këtë dispozitë ose të themi një klauzolë përjashtuese, më duket që futja e një kushti pengues të kësaj natyre, bën që të mund të shikohet në këtë këndvështrim ky lloj disbalancimi.

Për këtë arsye, tani Rregullorja është miratuar, por më duhet ta mbaja këtë qëndrim për Rregulloren, them që kjo pikë bëhet penguese edhe për aplikimin e skemës, çka do të thotë edhe në çmuarjen e kërkesës së vullnetshme që kanë bërë magjistratët, për të marrë pjesë në skemën e delegimit. Kështu që, kaq sa i përket miratimit së bashku Rregullores “Mbi skemën e delegimit...”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Kam përshtypjen që zoti Qoku konsideron që duhet rivënë në diskutim Rregullorja “Për skemën e delegimit...”. Në fakt, nuk e kemi pjesë të rendit të ditës. Duhet të operojmë sipas rendit të ditës.

Mundet që, nëse ka mendime të ndryshme, që ndajnë mendime të ndryshme, që ne duhet ta rishikojmë Rregulloren, ta bëjmë pjesë të një shqyrtimi tjetër. Sot kemi për shqyrtim këtë çështje të rendit të ditës dhe duhet të operojmë më tej.

Për procedurë, nuk e kuptoj nëse ne duhet të fillojmë të rikonsiderojmë Rregulloren dhe pastaj të merremi me rendin e ditës?! Më duket pak problematike kjo çështja që ngriti zoti Zëvendëskryetar.

Naureda Llagami: Kemi diskutime të tjera?

Brunilda Kadi: Atëherë, shkurtimisht. Në lidhje me atë që diskutoi kolegu Maksi, unë them që nuk është kjo rruga se si interpretohet neni 45, ose qëllimi. Mendoj që Këshilli vlerëson në çdo rast, kur krijon skemën e delegimit, çdo kërkesë që bëhet nga gjyqtari që pretendon dhe kandidon për t'u futur në këtë skemë. Pra nuk është vetëm që ai të plotësojë kriteret dhe Këshilli në mënyrë automatike ose detyrimisht e pranon atë. Jo! Mendoj që Këshilli vlerëson çdo rast, jo vetëm nëse i plotëson gjyqtari konkret kriteret, por edhe nevojën që do ketë rastin konkret për skemën, sepse skema mund të jetë e plotësuar, mund të mos ketë nevoja për atë gjyqtar konkret që kërkon të komandohet. Por, ajo që është më e rëndësishme është që Këshilli është përgjegjës për të parë mbarëvajtjen dhe funksionimin e të gjithë sistemit sepse nuk mund të pranojë në skemën

e delegimit një gjyqtar që vjen nga një gjykatë ku largimi i tij sjell më shumë dëm sesa dobi me përfshirjen e tij në skemën e delegimit. Kështu që Këshilli e ka këtë kompetencë, e bën këtë vlerësim kur vendos për pranimin ose jo. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi diskutime të tjera, për të kaluar në votim?

Atëherë, do fillojmë: Refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të zotit {...}. Kush është dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit të zotit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, për shkak se është duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër në kushtet e transferimit të përkohshëm. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Një kopje e këtij vendimit t'i njoftohet gjyqtarit në adresën e vendit të punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Kalojmë tek votimi për refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të zotit {...} ({...}), gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Kush është dakord?

Maksim Qoku: Kundër. Sepse më duhet të sqaroj që për mua gjykatësi ose magjistrati më mirë, më falni, i plotëson të gjitha kushtet që të marrë pjesë në skemën e delegimit, me rezervat që bëra për pikën /e/ të nenit 4 të Rregullores “Mbi skemën e delegimit..”.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, për shkak se është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij.

Kalojmë tek projektvendimi tjetër lidhur me refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të zotit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, për shkak se është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij. Kalojmë në votim. Kush është dakord?

Maksim Qoku: Kundër. Për të njëjtat arsye.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të zotit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, për shkak se është i

caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtarit në adresën e vendit të punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit tjetër, lidhur me refuzimin e kandidimit në skemën e delegimit të zotit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkak se është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij. Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Por me një saktësim, që gjyqtari {...} është gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, dakord edhe me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj.

Atëherë, projekt-akti miratohet si më poshtë: Këshilli vendosi refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të zotit {...} gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për shkak se është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Një kopje e vendimit do t'i njoftohet gjyqtarit në adresën e vendit të punës, Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 14.02.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:05 dhe mbaroi në orën 13:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër”.

Naureda Llagami: Atëherë, vijojmë me pikën 2 të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër”.

Ashtu siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushjen e përgjegjësive të tij në mbledhjen e datës 7 shkurt, miratoi me vendim nr. 22, Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit si dhe vendimin nr. 23 Rregulloren për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit.

Duke vlerësuar situatën aktuale që ka nëpër gjykata, kur deri ditën e sotshme janë depozituar pranë KLGJ rreth 179 kërkesa nga kryetarët respektiv të gjykatave për delegime të 259 gjyqtarëve, si dhe duke vlerësuar se skema e delegimit dhe e transferimit të përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës i propozon Këshillit të miratojë rregullat dhe procedurën për caktimin e gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në

një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Ky rregullim vlerësohet se do t'i japë zgjidhje situatës së krijuar, pra vjen si një domosdoshmëri të situatës faktike të krijuar pranë Këshillit, për shkak të një fluksi shumë të lartë të kërkesave për delegim që kanë bërë gjyqtarët e gjykatave dhe për këtë gjë, ky Komision, ka hartuar këto rregulla.

Është për të sjellë në vëmendje që Komisioni, këtë propozim e ka shqyrtuar duke konsultuar edhe me misionet ndërkombëtare të asistencës, siç është misioni EURALIUS dhe USAID për të cilët gjej rastin t'i përhëndes dhe t'i falenderoj për kontributin që po i japin Këshillit gjatë kësaj periudhe.

Për më tepër, ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Në vijim të fjalës edhe të Kryetares, arsyeja sepse e kemi propozuar miratimin e këtij projektvendimi është vetë situata aktuale ku një numër i konsiderueshëm gjykatash, për çështje të veçanta gjyqësore ka kërkuar plotësimin e trupave gjykues, qoftë me një, dy apo edhe tre gjyqtarë. Në kushtet kur skema e delegimit nuk funksionon, pasi edhe më herët konstatoam që vetëm 4 kandidatë ... kanë shprehur pëlqimin për të marrë pjesë në skemë delegimi, ndërkohë që problematika/nevojat e gjykatave lidhen me çështje të veçanta gjyqësore, pra jo me një numër të konsiderueshëm ku do të bëhej transferimi i përkohshëm, qoftë me pëlqim apo pa pëlqim, për të zgjidhur këtë ngërç të krijuar, kemi propozuar mbi bazën e autoritetit që na jep Kushtetuta, një draft rregullash për mënyrën se si të zgjidhim situatën që ne kemi, duke shpresuar që në një të ardhme të funksionojë skema e delegimit apo ne të mundemi rast pas rasti të aplikojmë transferimin e përkohshëm me ose pa pëlqim, nëse situatat që do të na paraqiten do të kërkojnë pikërisht përdorimin e këtij mjetei ligjor.

Në relacion kemi shpjeguar me hollësi rregullimet që ne kemi propozuar.

Kemi vendosur disa kritere për të konsideruar një shpërndarje të drejtë dhe efektive të çështjeve që paraqiten si nevojë të gjykatave të caktuara. Kemi konsideruar edhe procedurën e shpërndarjes së tyre përmes shortit për të pasur një gjykatë të krijuar me ligj, sikundër Kushtetuta dhe ligji organik na kërkon. I kemi bërë në mënyrë të detajuar që në çdo rast të kemi mundësi që të operojmë, duke qenë transparent për

veprimtarinë tonë, por edhe që gjykatat të përballen sipas ligjit me çdo çështje që i paraqitet.

Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët, por besoj edhe më herët kemi diskutuar edhe bashkërisht, përfshirë edhe dy misionet që na asistojnë, por gjithsesi mund të bëjnë ndonjë koment apo pyetje, t'ju kthejmë edhe ndonjë përgjigje, nëse do të jetë vendi.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska, për prezantimin e projekt-aktit?

Kalojmë në diskutime? Ka ndonjëri diskutim lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë kam qenë kundër gjithmonë këtyre zgjidhjeve të mesme, kështu që do t'i qëndroj me racionalitet arsyes pse arritëm këtu dhe çfarë çalon sipas mendimit tim.

Së pari, gjithmonë i kam parë të lidhur 45-ën me 46-ën “Për statusin...” dhe nëse thotë ligji, nuk mundet që skema e delegimit të ketë magjistratë të disponueshëm, atëherë të kalojmë tek transferimi. Por kam përshtypjen, ndër ato që kam lexuar tek akti, nuk i është qëndruar, të paktën në vija të përgjithshme, rekomandimeve të misionit, i cili në aktin e tij referon që mundet, pra Këshilli i ka mundësitë dhe citoj: “Të miratojë një akt normativ të përkohshëm që detajon si trajtohet nevoja për delegimin në një çështje të caktuar pa pëlqim në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave të gjykatave”. Unë has dy terma, thuhet “...janë të pamjaftueshme” dhe në dokumentin që është paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në pikën II “Fusha e zbatimit”, thuhet “...në rast të pamundësisë së zbatimit...”.

Them të drejtën, termi “pamjaftueshëm” dhe “pamundësi zbatimi” nuk më lidhen sepse nëse flasim për pamundësi zbatimi, atëherë themi që kemi një lapsus të ligjvënësit, i cili ka parashikuar diçka, duke edhe e ditur që nuk do të realizohet. Ndërkohë që, qoftë misioni por qoftë edhe logjika ime është që neve mundet këtë rrugë të ndërmjetme ta bëjmë, por duke e lidhur me të vërtetë me një kohshmëri, kohshmëri e cila mund të shkojë ose me përcaktimin e një afati kohor ose me përcaktimin e numrit aktual të nevojave që kanë gjykatat për delegimet. Sepse, për më tepër, se si unë e lexoj aktin, i

detajuar, i qartë dhe jashtëzakonisht i bërë mirë (s'kam asgjë) është identik me skemën e dikurshme të delegimit që bënte ish-KLD-ja, organ i cili ne e kemi zëvendësuar dhe përpara se të aplikoheshin ligjet për reformën, çka do të thotë, këtë praktikitet që na jep ky akt, bën që jo vetëm që e shmang realisht e bën të pamjaftueshme skemën e delegimit të pamundur për t'u zbatuar por edhe është praktik për t'u zbatuar nga ana jonë sepse çdoherë që ka një delegim, ne fare lehtë dhe mirë, me detajimet që kemi bërë, mund të caktojmë një gjyqtar dhe shkojmë në normalitet. Por ama kjo na çon, e para që ne të shkojmë në përsëritje të një skeme që ka qenë identike dhe e dyta, që ne po shkelim një afat ligjor 3-mujor, brenda të cilit ne duhet ta realizojmë skemën dhe nëse nga termi “i pamjaftueshëm” skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm, kalojmë në pamundësinë e zbatimit, atëherë ne kemi probleme në interpretimin e këtyre termave. Të kuptojmë që kjo pamundësi çon në mos realizueshmëri apo kjo pamjaftueshmëri na çon në këtë zgjidhje të ndërmjetme për të cilën jam dakord dhe ta bëjmë. Por nëse në këtë formë e mbajmë aktin, duke iu referuar gjithmonë edhe asaj çka kundërshtova për atë pikën në skemën e delegimit, mendoj që dalim nga ajo çka vullneti i ligjvënësit ka qenë dhe hyjmë në një rrugë tjetër, mbase më e lehtë për ne, por më duket jo në brazdën e ligjshmërisë.

Neni 45 është çka shprehet për skemën e delegimit dhe neni 46 thotë, “në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistratë të disponueshëm, aplikojmë këtë nen”. Pra unë e shoh shumë të lidhur delegimin dhe transferimin e përkohshëm, por nuk e shoh nëse nuk e lidhim me një kohshmëri këtë akt se në ç'plan mund ta vendosim dhe në ç'masë dhe kohë duhet ta zbatojmë.

Për mos të thënë, sepse e kam thënë, që është një akt që i qëndron paralel në plan përballë dhe të kundërt skemës së delegimit dhe nuk e lë që të bëhet e zbatueshme, sepse është shumë praktik, pavarësisht se si e qysh e tek, është praktik. Por ama është identik se si ka qenë. Nëse me logjikën e të kundërtës do të ishte mirë ashtu siç ishte, nuk kishte pse të bëhej ky rregullim. Prandaj edhe jam në tërësi kundër, për sa nuk jemi të lidhur me një kohshmëri. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, zoti Toska të lutem!

Ilir Toska: Po! Atëherë, dua të sqaroj logjikën që ka pasur ligji dhe ne që kemi paraqitur këtë propozim.

Sipas logjikës së ligjit, dy janë mekanizmat që zhbllokojnë një situatë në rast nevoje të një gjykate: skema e delegimit; në rast të padisponueshmërisë së gjyqtarit në skemën e delegimit, transferimi i përkohshëm ose pa pëlqim. Në rastet e transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim duhet të konsiderojmë se gjyqtari lëviz nga pozicioni ku është. Ndërkohë, situatat që ne na paraqiten nuk kanë të bëjnë me një numër të madh çështjesh në një gjykatë, ku nevoja është që një gjyqtar duhet të plotësojë një vend vakant që të përballojë ngarkesën në atë gjykatë. Nevojat që na paraqiten janë çështje në një numër të kufizuar. Në këto kushte, sa kohë nuk funksionon skema e delegimit sepse nuk kemi për momentin gjyqtarë (nuk e dimë nëse do kemi në të ardhmen), sa kohë nuk është oportune/e dobishme të aplikohet transferimi i përkohshëm me ose pa pëlqim, kemi menduar që do të jetë alternativa e tretë (jo e para), pra në çdo rast, sa herë do të kemi çështje caktimi të gjyqtarëve për një çështje të caktuar, Këshilli duhet të konsiderojë së pari skemën e delegimit, më tej duhet të konsiderojë transferimin e përkohshëm me ose pa pëlqim dhe alternativa e tretë, në pamundësi të zbatimit të të dyjave, duhet të jenë këto rregullime që ne kemi propozuar sipas këtij projektvendimi.

Sa i përket afatit, bë fakt ne kemi kushtëzuar aplikimin e këtyre rregullave vetëm në rast të pamundësisë së zbatimit të dy skemave që ligji ka përcaktuar nenet 45-46. Gjithsesi, për të qenë koherent, mundet të shtojmë një pikë dhe të themi që Këshilli i Lartë Gjyqësor periodikisht, çdo 6 muaj, vlerëson zbatimin në vijim të këtij vendimi, që do të thotë që edhe në mënyrë të përgjithshme, jo vetëm rast pas rasti, Këshilli mund të konsiderojë vijimin e zbatimit të këtij vendimi, të këtyre rregullave që ne kemi propozuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Alban!

Alban Toro: I ezauroi kolegu, por mund të shtojmë edhe një gjë tjetër tek uebsajti (*website*) jonë, siç e kam përmendur edhe më herët, që në çdo rast, në uebsajtin (*website-in*) tonë të jetë një ftesë e përhershme drejtuar të gjithë gjyqtarëve për të marrë pjesë në skemë delegimi dhe në atë të transferimit. Në këto kushte, nëse do të ketë

kandidatura të tilla, pastaj edhe funksionon skema, automatikisht kjo rregullore nuk do të zbatohet, se janë dy skemat preferenciale që funksionojnë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, ashtu sikundër folën edhe Iliri me Albanin, unë e kuptoj që ky vendim që ne miratojmë sot për disa rregulla për mënyrën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve në gjykatat e tjera, është përjashtim i skemës së delegimit dhe transferimit. Në kuptimin që, në këtë vendim ne do të shkojmë vetëm atëherë kur nuk kemi të zbatueshme 45-ën dhe 46-ën. Në këtë aspekt, propozimi i bërë nga Iliri nuk mendoj se është i nevojshëm sepse sa herë që do kemi delegim, do shohim: - Kemi skemë delegimi? –Kemi gjyqtarë të disponueshëm? –Mund të aplikohet transferimi? Dhe këto kërkojnë një vendimmarrje dhe një vlerësim të Këshillit në çdo rast, jo vetëm periodikisht. Pra vetë fusha e zbatimit të këtij vendimi e ka përcaktuar edhe diskrecionin dhe atributet e Këshillit për zgjidhjen e çështjes.

Lidhur me atë që propozon Maksi për pjesën e krijimit të një skeme paralele në kundërshtim me atë çka parashikon ligji, që parashikon skemën e delegimit apo transferimin e përkohshëm, vlerësoj që sigurisht që ligji nuk parashikon në mënyrë të shprehur se çfarë do bëhet në rast se 45-a dhe 46-a nuk funksionojnë. Në këtë rast nuk bëhet fjalë që Këshilli ka vullnet që të mos ngrejë një skemë delegimi. Çështja shtrohet kur kjo skemë delegimi nuk është funksionale. Ne aktualisht kemi të gjithë afatin kohor, edhe afatin 3 muaj, nuk po e shkelim afatin 3 muaj, -siç tha Maksi, -për të ndërtuar një skemë delegimi. Problemi është që nuk mund të presin 200 kërkesa dhe delegime derisa të krijohet kjo skema e delegimit. Meraku qëndronte tek të gjithë ne, që ne të vendosim disa rregulla për këtë skemë delegimi dhe atë bëmë, vendosëm kriteret dhe procedurën për skemën e delegimit. Sot jemi në një moment kur këtë skemë delegimi që ne po e krijojmë, e kemi të padisponueshme për ta vënë në funksion dhe nëse Maksi ka ndonjë propozim tjetër ,veç këtij vendimi, se si mund të zgjidhet situata, ne mund ta diskutojmë. Por, për të deleguar gjyqtarë për të gjykuar çështje të veçanta, është e nevojshme që të krijohet/të nxirret një akt tjetër nga Këshilli dhe ky akt tjetër, sigurisht që do bazohet në dispozitat kushtetuese. Nuk po ndjekim as praktikën e mëparshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, po miratojmë një akt, duke marrë parasysh nevojat që ka sistemi, duke marrë

parasysh dhe të gjitha parimet që janë vendosur në Kushtetutë dhe në ligj për mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve. Kaq kam.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Jam dakord me tre parafolësit edhe me këtë që sapo tha Brikena. Thjesht doja të shtoja diçka sepse kolegu Qoku ngriti si diskutim që qenka problem që qenka shumë praktike kjo skema që do miratojmë sot, një dhe e dyta, është përdorur dikur nga ish-KLD-ja. Unë mendoj që, që të dyja këto argumenta nuk janë negative. Fakti që është praktike dhe që është përdorur nga KLD-ja, ky s'mund të jetë automatikisht diçka e keqe dhe negative. Shumë mirë që është praktike dhe shumë mirë që është përdorur nga KLD. Është një rregullore që kam përshtypjen është parë edhe modeli i mëparshëm, por ajo është pasuruar gjatë shumë viteve dhe ka pasqyruar gjithë problematikat që kanë dalë gjatë viteve në zbatimin e kësaj skeme. Kështu që nuk mendoj se këto mund të shërbejnë si argumenta për të votuar kundër kësaj situatë.

Përtej kësaj, doja të thoja edhe diçka tjetër, unë personalisht, siç mund t'ju kujtohet, që në herën e parë, kur u diskutua se si do të zgjidheshe situata, kam votuar dhe kam diskutuar që të mbërrinim tek kjo pikë që jemi sot, që në fillim, që në krye të herës kur ishte diskutimi se si do zgjidheshe situata për caktimin e gjyqtarëve në çështje të caktuara sepse vlerësohej që kjo situatë nuk është zgjidhur shprehimisht nga ligji dhe ne na buron detyrimi që ta zgjidhim nga Kushtetuta dhe nga përgjegjësia jonë që e kemi nga kjo Kushtetutë dhe nga ligji. Kështu që, mendoj që nuk ka pengesë që të vijojmë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Qoku!

Maksim Qoku: Diçka për të sqaruar, se ma hoqe nga konteksti.

E para, nuk gjykova aspak KLD-në dhe më tepër atë lloj skeme që përdorte.

E dyta, thashë që, nëse, t'i referohem fjalëve të tua, thua që e ke thënë që kështu do ndodhte, atëherë i bie që ke qenë e lexueshme ndaj vullnetit të legjislatorit. Pra, legjislatori ka gabuar. Kjo që ka zgjedhur nuk është funksionale, -thoni ju, -jo e pamjaftueshme, funksionale. Ndërkohë, unë thashë tjetër gjë. Është një skemë identike që është përdorur dhe legjislatori, me ndryshimin e ligjit, aq më tepër dhe me konstituimin e organit të ri, nuk e parapa të nevojshme dhe të duhur që ta bënte si më parë. Dhe ne

ç'bëjmë? Fusim termin 'i pamundur për t'u zbatuar' dhe kalojmë në një skemë që ishte si dikur. Tani, unë thashë, -mos po deformatojmë vullnetin e legjislatorit sepse 45-a dhe 46-a janë konceptuar në ligjin e ri për një funksion të lidhur me njëra-tjetrën. Dhe unë te pranoj, thashë të jem racional, e fusim planin C, këtë akt, për të bërë në një koherencë këto 200 delegime, por jo për ta bërë rregull sepse ky rregull është i njëjtë me si është bërë dikur, çka do të thotë nuk parashikohet të bëhet si rregull nga ky ligj që është në fuqi dhe aq më tepër thashë që bie ndesh direkt me mundësinë për ta bërë funksionale skemën e delegimit. Pra vullnetet e mira, zakonet e mira i pranoj. Nuk e vë në dyshim fare se si është vepruar më parë. Por thashë, nuk besoj që ka qenë synimi i ligjvënësit që të shkohet tek kjo. Ka qenë më përtej. Kjo ishte logjika.

Naureda Llagami: Më fal! Të sqaroj edhe unë diçka.

Ne jemi shumë të ndërgjegjshëm që Këshilli, në këto momente dhe komplet situata e gjyqësorit nuk është një situatë normaliteti. Përkundrazi, është një situatë emergjence. Pa diskutim që vullneti i legjislatorit, kur ka parashikuar dispozitat, ka qenë për një situatë të normalitetit të sistemit tonë gjyqësor. Aktualisht, për shkak të procesit të vetingut, Këshilli nuk mund të aplikojë dot dispozitat përkatëse.

Këshilli e provoi, hartoi rregulloret përkatëse, mori masat për të informuar të gjithë gjykatat dhe me gjithë afatet që Këshilli reagoi, konstatuam me dhimbje që asnjë nga gjykatat nuk patën një lloj dëshire pëlqimi të shprehur, si për aplikimin e njërës rregullore ashtu edhe për aplikimin e rregullores tjetër. Për më tepër që ne këtë çështje, në mos gaboj, e kemi pasur prioritet para pesë a gjashtë mbledhjesh, pra që kur Këshilli u konstitua, çështja e delegimeve ishte një çështje prioritare. Morëm gjithë kohën e nevojshme që të zbatonim ligjin në mënyrën më korrekte të mundshme. Në situatën që neve morëm masat, miratuam rregulloret, i çuam për botim, i informuam vetë, komplet stafi i KLGJ-së ndikoi për t'i zbatuar sa më shpejt dhe për të marrë njoftimet e të gjithëve për të shprehur vullnetin, dhe në situatën që nuk kemi mundësi, pra Këshilli është në pamundësi për ta krijuar këtë grupin e këtyre gjyqtarëve të cilët do të ishin "të gatshëm" për t'u përdorur për delegimet.

Atëherë neve si mund të qëndrojmë?! Mund të qëndrojmë në situatë pa vepruar?!
-Këshilli nuk e ka këtë luks të rrijë në këtë lloj situatë sepse sistemi kërkon që të veprohet.

Për merakun tjetër të çështjes së afateve dhe karakterit të përkohshëm.

Ne kuptohet, tek pika 2 e kemi kushtëzuar kur është aplikimi. Fakti që ne e kemi kushtëzuar, tregon që nëse ne nuk aplikojmë dy rregulloret e mëparshme, pra nëse i hapim ato për aplikim, nuk na aplikojnë, do shkojmë kështu. Fakti që e kemi me kusht, për mua ezauron edhe shqetësimin që keni lidhur me afatet kohore.

Ne gjendjen e emergjencës që ka sistemi për shkak të vetingut, ne nuk mund ta parashikojmë. Nëse misionet e parashikojnë, unë me thënë të drejtën nuk e parashikoj dot se sa do zgjasë kjo situatë. A do zgjasë gjashtë muaj. A do zgjasë 1 vit. A do zgjasë 3 vjet. Unë nuk e di se sa mund të na zgjasë kjo situatë dhe nuk kemi një vlerësim se sa mund të na zgjasë. Kemi disa raporte se sa kanë proceduar në shqyrtimin e çështjeve organet e vetingut, por ne nuk dimë se sa do zgjasë kjo.

Kështu që çdo propozim lidhur me një afat konkret, për mua më duket jo racional për t'u përfshirë. Më duket zgjedhje shumë e goditur nga ana e Komisionit që e ka kushtëzuar me detyrimin që të aplikohen një herë dy rregulloret e tjera, më pas të futet ky mekanizëm. Dhe pranoj edhe sugjerimin e bërë nga zoti Toro, që Këshilli në uebsajtin (*website-in*) e vetë, të lejë thirrjen për aplikim në këto lloj skemash për të gjitha, non stop ta lejë të hapur si thirrje. Kush është i interesuar... Kaq mund të bëjë Këshilli në masat e veta. Por në kushtet që ne kemi detyrim pëlqimin dhe të tjerët nuk na japin pëlqimin, ne duhet të reagojmë.

Kështu që, në këtë lloj situatë, unë vlerësoj që nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, projekt-akti ka adresuar shqetësimet që ka Këshilli në këto momente.

Brikena Ukperaj: Nëse Maksi ka ndonjë propozim tjetër.

Marçela Shehu: Lidhur me merakun që ka Maksi lidhur me përkohshmërinë e këtij akti normativ. Atëherë ky akt, që në konceptim dhe në gjithë përmbajtjen e tij, i referohet një karakteri të përkohshëm. Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për këtë. Nëse skema do mund të ngrihet edhe nesër, ky vendim sigurisht që nuk do të zbatohet. Pra ky është një akt që ne na zgjidh situatën në të cilën ne ndodhemi sot, por ky vendim,

sigurisht që nuk do të ketë më fuqi në momentin që do ngrihet skema, që mund të jetë edhe nesër apo pas 1 jave. Kështu që, akti në të gjithë përmbajtjen e vet, e ka zgjidhur këtë shqetësim që s'është vetëm i Maksit por besoj është i gjithë i joni.

Maksim Qoku: Atëherë, sugjeroj që të shikohet mundësia të tërhiqet në debat problemi i rregullores mbi skemën e delegimit dhe debatojmë në lidhje me pikën /e/ të nenit 4, që të sqarojmë problemin e funksionalitetit. Pastaj se si do mbajmë qëndrim në lidhje me atë pikë, mund të jap edhe sugjerime të tjera.

Naureda Llagami: Të projekt-aktit e ke fjalën?

Maksim Qoku: Jo, jo! Flas për rregulloren.

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë. Në rendin e ditës, ne kemi këto lloj çështjesh dhe ne nuk mund të kalojmë në rendin që kemi dhe të kthehemi tek një rregullore që e kemi miratuar. Pa diskutim, propozimin tuaj ju mund t'ia kaloni Komisionit përkatës, i cili vlerëson propozimin dhe mund ta rishikojë edhe një herë rregulloren në bazë të propozimit tuaj, zoti Qoku. Për momentin po flasim për rendin e ditës, për miratimin e projektvendimit, lidhur me rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për caktimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, i cili, pas miratimit tuaj do të aplikohet vetëm nëse nuk gjen zbatim skema e delegimit dhe e transferimit.

Unë ju ftoj të kalojmë projekt-aktin, nëse s'kemi më diskutime, ta kalojmë për votim. (Në tërësi).

Maksim Qoku: Kundër.

(Votimi i zonjës Kadi nuk është regjistruar. Zonja Kadi është pro, referuar shënimeve të mbajtura gjatë mbledhjes nga stenografja.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, akti u miratua në parim.

Nëse njëri nga ju ka propozime konkrete për nenet e rregullores dhe për paragrafët që janë parashikuar në rregullore, mund të japi propozimin përkatës.

Brikena Ukperaj: Atëherë, ne paraprakisht e kemi diskutuar edhe me anëtarët e Komisionit të Karrierës, të gjitha dispozitat e vendimit, ajo që është diçka e re dhe që ndoshta do duhet edhe një sqarim nga kryetari i Komisionit, është mënyra e delegimit të çështjeve në gjykatat e apelit. Është konkretisht pika 7 e vendimit, në nën-ndarjen e saj. Më fal, kreu VII, pika 4. Atëherë, thotë: “4. Në rastin e nevojave të gjykatës së apelit për një çështje gjyqësore të veçantë, që konsiston në caktimin e më shumë se një gjyqtari për gjykimin e saj, si rregull, përzgjedhja me short e një gjyqtari nga gjyqtarët e gjykatës së apelit të përcaktuar..., nënkupton përzgjedhjen me short, për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore, edhe të gjyqtarëve të tjerë që janë në të njëjtin trup gjykues me gjyqtarin e përzgjedhur i pari. ...” Pra që do të thotë që në qoftë se duhet delegimi i një trupe gjyqësore, mjafton që të përzgjidhet një gjyqtar dhe fati i të gjithë trupit gjykues është i përcaktuar sepse është trupi gjykues që gjykon me atë gjyqtar, në gjykatën nga do të caktohen. Se kur janë 2 gjyqtarë, kuptohet që gjyqtari i tretë do jetë relator.

Si do të bëhet përcaktimi i relatorit të trupit gjykues?

Ky vendimi jonë do thotë që, gjyqtari që ne përzgjedhim, do jetë edhe relatori? Apo relatori do të hidhet me short në gjykatën ku do të shkojë të gjykohej. Këtë kam unë merak, për t’i qëndruar rregullave që caktimi i relatorit bëhet me short.

Ilir Toska: Atëherë, rasti kur janë tre gjyqtarë, është rasti që ju keni problematikën e të kuptuarit se çfarë nënkupton kjo gjë?

Brikena Ukperaj: Shumë mirë që është bërë kështu, që mos të prishim të gjithë trupat gjykuese të gjykatave, por një trup gjykues kur shkon në një gjykatë, t’i gjykojë të gjitha çështjet dhe të mos dëmtojë funksionalitetin e të gjitha trupave gjykuese në një gjykatë apeli.

Çështja që më shqetëson është, si do të bëhet përzgjedhja e gjyqtarit relator që do ta shqyrtojë çështjen, sepse ne nuk përcaktojmë dot si Këshill gjyqtarin relator. Ne përcaktojmë trupin gjykues që do ta gjykojë dhe aktualisht, të paktën nga eksperiencia ime

(si është operuar deri tani), kur shkonim të deleguar në një gjykatë tjetër apeli, të tre gjyqtarët që shkonim, përcaktimi i relatorit bëheshe me short elektronik... Po! Të tre gjyqtarët, hidheshe short elektronik dhe aty e përcaktonte relatori. Kjo bazoheshe tek ligji që relatori përcaktohet me short (Kodi i Procedurës).

Problemi është që ky është short që përcakton trupin gjykues.

Ilir Toska: Ky short përcakton gjyqtarët.

Konsideron gjyqtarin e parë që përzgjidhet me short dhe pastaj dy të tjerët automatikisht, nëse janë në një trup gjykues, konsiderohen si përzgjedhur nga shorti.

Sot e njëjta logjikë funksionon edhe në shortin elektronik që funksionon në gjykatat e apelit. Përzgjidhet relatori i çështjes, që është gjyqtari i parë, dhe automatikisht konsiderohen si të përzgjedhur nga shorti dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues me të cilën është vendosur që në fillim të vitit që janë në përbërje të një trupi gjykues të caktuar. Edhe në rastin që kemi për shqyrtim, me short është bërë, short po bëjmë. Do caktojmë gjyqtarin e parë (nëse bëhet fjalë për tre) dhe automatikisht dy të tjerët janë të përzgjedhur. I pari është relatori.

Brikena Ukperaj: Atëherë, propozoj që të shtohet që gjyqtari i parë është edhe relatori i trupit sepse duhet ta përcaktojmë këtu, ndryshe nga ç'parashikon Kodi i Procedurës Civile ose Kodi i Procedurës Penale.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo, sepse ne këtu do të përzgjedhim trupin gjykues.

Më fal, ne do marrim një vendim – po ta bëj më konkrete – ne do marrim një vendim dhe do themi, për çështjen X, për Gjykatën e Apelit Korçë, caktohen tre gjyqtarët, nga të cilët ky është relator. Do ta themi këtë. Se në qoftë se kemi këtë qëllim, që gjyqtari i përzgjedhur do tërheqë edhe trupën e vet, atëherë ky gjyqtar është relator. Nuk është e nevojshme që të hidhet prapë në short atje. Nuk është bërë kjo deri më sot, prandaj i mëshoj faktit. Më kupton? Ta cilësojmë.

Brunilda Kadi: Edhe në diskutimet para mbledhjes që kemi bërë, unë nuk e kuptoj shqetësimin e Brikenës. Ideja është që pse, në gjykatë, këtë e cakton shorti elektronik?

Brikena Ukperaj: Po!

Brunilda Kadi: Te rregullorja është bërë. Si rregull, është elektronik, edhe kjo. Pra nuk mendoj që mënyra se si hidhet shorti është problem procedural, domethënë i ligjit procedural. Mënyra se si hidhet shorti, elektronik apo manual...

E kuptova pra.

Njëherë, e para e punës, ky nuk është problem vetëm për apelin sepse mund të ketë kërkesë për trup gjykues edhe në shkallë të parë.

Atëherë, duke qenë se gjykata, logjikën e shortit e ka që kur tërhiqet dhe caktohet, ai gjyqtari që i bie çështja, qoftë nëse do jetë me trup treshe ose pesëshe, si e kanë gjykatat e tjera, automatikisht është relatori sepse këtë e thotë ligji, -apo jo?

Në gjykatë, kur hidhet shorti... kur hidhet shorti, ty si gjyqtar i apelit ose i shkallës së parë, të bie çështja X, ti e ke me trup gjykuese këtë sipas ligjit. Ti je relatori, -apo jo? E pse duhet të jetë ndryshe nga kjo që do hedhë tani Këshilli? Vetëm sepse nuk do ta bëjë elektronik shortin? Ky është shqetësimi?

Ilir Toska: Kam përshtypjen që Brikena ka shqetësimin se atë që ka ndodhur deri më sot, me atë që do konsiderojmë që duhet të ndodhë në të ardhmen. Pra nëse në rastet e deri më sotme, ish-KLD zgjidhte tre gjyqtarë dhe pastaj gjykata atje operonte me një short elektronik mes atyre të treve, ne ndryshe nga më parë, po konsiderojmë të ezauruar shortin, qoftë për trupën në tërësi, ashtu edhe për relatorin. I vetmi shqetësim që kuptoj nga Brikena është që ne këtë gjë duhet ta evidentojmë që gjykatat mos të konfondohen, që të vazhdojnë me praktikën e mëparshme apo me këtë që ne po konsiderojmë, -apo jo?

Naureda Llagami: Atëherë, propozimin e Brikenës, do ta reflektoni në cilësinë e kryetarit të Komisionit?

Marçela Shehu: Edhe unë jam dakord me propozimin e Brikenës, që gjyqtarët të jenë të qartë, që e njëjta logjikë që përdoret brenda gjykatës, në momentin kur gjykohet një çështje me tre gjyqtarë, e njëjta logjikë do të zbatohet edhe në këtë rast, që mos të konfondohen nëse do hidhet shorti.

Naureda Llagami: Okej! Riformulim konkret tani, se do e kalojmë për miratim është puna.

(Riformulohet pika 4, kreu VII sipas propozimit të bërë nga zonja Ukperaj. Duke qenë se mikrofonat kanë qenë të fikur dhe regjistrimi nuk është bërë i mundur, atëherë,

duke u bazuar në shënimet e bëra gjatë mbledhjes, ndryshimi i bërë është shtimi i frazës “i cili do të jetë relatori i çështjes”, pas frazës “...gjyqtarin e përzgjedhur i pari”.)

Atëherë, të hedhim në votim me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj? Pranojmë në tërësi komplet aktin me gjithë propozimin e bërë? E kaluam në parim.

Kemi diskutime? Se ne kemi thënë që kur flasim për nene të caktuara, gjithsecili nga ne do ngrejë dorën dhe do bëjë propozimin përkatës për nenin.

Do e hedhim rregulloren në tërësi me gjithë ndryshimet, nëse nuk keni më diskutime për nenet përkatëse.

Atëherë, kalojmë në votim me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj që u fiksua në procesverbal dhe tek projekt-akti. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, sipas tekstit bashkëlidhur vendimit të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe propozimit të bërë nga zonja Ukperaj. Kërkesat e ardhura, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga kryetarët e gjykatave, ndërmjet të cilave është kërkuar delegimi i gjyqtarëve për të plotësuar trupat gjykues, do të trajtohen bazuar në rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 14.02.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:05 dhe mbaroi në orën 13:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Ashtu siç e kemi thënë edhe në fillim të mbledhjes apo në mbledhjen e mëparshme, ky projektvendim ishte parashikuar të diskutohej në mbledhjen e datës 7 shkurt por që u tërhoq për një përmirësim të mëtejshëm. Ashtu siç ju kam raportuar edhe tek mbledhja e ardhshme, vazhdoj t’ju them që pranë zyrës së protokollit të Këshillit janë depozituar një numër i madh ankimesh, që bëhet fjalë për rreth 183 ankime, lidhur me vendimmarrjen e Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës apo pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Për shqyrtimin e këtij projekt-akti, Komisioni kompetent është Komisioni i Disiplinës. Për sqarim të mëtejshëm të këtij projekt-akti ia jap fjalën zotit Medi Bici, kryetar i këtij Komisioni.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç e thatë edhe ju, ky projektvendim ka qenë edhe më parë për shqyrtim në seancë plenare, pasi Komisioni i Disiplinës kishte idenë që përveç këtyre 183 çështjeve për të cilat kishte marrë vendim arkivimi ose pushimi Kryeinspektorja, mendonim që duheshin trajtuar edhe ankesat që vijnë dhe vazhdojnë të vijnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo ide nuk u pranua nga një pjesë e anëtarëve të Këshillit. Gjithashtu, një problem ishte afati kohor që duhet të funksiononte ky Komision, që Komisioni i Disiplinës kishte mendimin që ky afat duhet të lidhesh me ngritjen e institucionit të ri, pra të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kurse një pjesë e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*Këshillit të Lartë Gjyqësor*), kanë mendimin se duhet të lidhet ngushtësisht me këto 183 çështje. Meqenëse është kërkuar një ndihmë edhe e dy misioneve që na asistojnë, në lidhje me ankimet kur nuk ka marrë vendim Kryeinspektori, edhe ne si Komision jemi tërhequr dhe jemi dakordësuar duke ardhur me mendimin e kolegëve tanë, që ky Komision të ngrihet vetëm për shqyrtimin e 183 çështjeve, pra numri i çështjeve që ka marrë vendim arkivimi ose pushimi Kryeinspektorja e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këto i kemi reflektuar në projektvendim, si në kokë ashtu edhe në afat. Afati do të lidhet ngushtësisht me këto 183 çështje që i keni të reflektuar në pikën 8.

Bashkangjitur keni pasur edhe relacionet. Pikat e tjera janë të pandryshuara. Kështu që mendojmë të votohet nga seanca plenare.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Meqenëse propozimi për këtë, bëhet fjalë për një çështje të caktuar që dihet që ka një fillim dhe një fund, ndoshta mos duhet që Komisioni të jetë Ad Hoc, jo i përkohshëm, pra që bëhet vetëm për një çështje të caktuar. Thjesht e hedh si diskutim.

Naureda Llagami: E njëjta gjë është edhe Ad Hoc edhe i përkohshëm, është për një çështje.

Brunilda Kadi: Ad Hoc është për një çështje. Kurse i përkohshëm është... siç është për shembull Komisioni i Vetingut, është i përkohshëm. Kurse Ad Hoc...

Naureda Llagami: Atëherë, ne jemi munduar besoj edhe Komisioni është munduar të ndjekë komplet terminologjinë dhe kemi zbatuar për analogji rregullat që parashikon neni 62 i ligjit “Për qeverisjen...” dhe pika 13. Kështu që, për këtë arsye edhe Komisioni ka vazhduar me të njëjtat rregulla që ka parashikuar dhe po të shohim edhe përmbajtjen, edhe mënyrën e shortit edhe të gjitha i kemi përcaktuar sipas këtyre rregullave, kështu që.

Brunilda Kadi: Ja ta mbaroj.

Atëherë, unë e di që ligji në një dispozitë i barazon por që të gjithë e dimë që Ad Hoc dhe i përkohshëm janë dy gjëra të ndryshme. Megjithatë, e thashë për diskutim.

Do propozoja edhe diçka. Këtu tek pika 2, unë mendoj që duhet të parashikojmë në këtë vendim se si do zëvendësohen anëtarët nëse kanë konflikt interesi. Se mund të ndodhë për shembull që një nga ne gjyqtarët mund të jetë anëtar komisioni dhe mund të rastisë që një nga ankimet mund të jetë i tij ose edhe anëtarët jo gjyqtarë mund të kenë një konflikt interesi. Kështu që, që të shmangim çfarë do bëjmë në të ardhmen, le të parashikojmë edhe dy zëvendësues për rastet e konfliktit të interesit.

Naureda Llagami: Nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë sepse formimi i këtij Komisioni është me short. Kështu e thotë ligji pra. Në momentin që njëri nga anëtarët do ketë, ne do hedhim shortin për zëvendësim për atë çështje të anëtarit. Pra nuk e kemi situatën si tek komisionet e përhershme që ne parashikojmë edhe zëvendësuesit. Në rastin konkret, për shkak të karakterit të përkohshëm që ka ky komision, mënyra e operimit është përmes shortit. Do e bëjmë me short. Në situatat që kemi, do mblidhemi, do bëjmë shortin për atë person. Kështu që, nuk mund ta parashikojmë, se me short me zëvendësues ne nuk i bëjmë dot. Kështu që, e lejmë.

Brikena Ukperaj: Nga përmbajtja e projektvendimit, në fakt, veç ngritjes së këtij Komisioni është përpjekur që të vendosen disa rregulla për mënyrën se si do të funksionojë ky Komision i Përhershëm. I përkohshëm, -më falni. I përkohshëm, -e korrigjova. Mendoj që duhet të reflektohet parashikimi që caktimi i këtyre çështjeve duhet të bëhet me short, secili nga anëtarët duhet të funksionojë si relator sepse janë

vendime që lidhen ngushtësisht me statusin e gjyqtarit. Kështu që, nuk e di si e ka menduar Komisioni, do bëjë një rregullore më pas, apo...? Nuk e di si do i marrin për 180 veta të tre vendimin? Do ketë ndonjë anëtar relator për çdo çështje dhe pastaj do merret vendimi nga Komisioni? Kjo ishte.

Medi Bici: Mendimi im është se propozimi që bën zonja Ukperaj në këtë rast nuk qëndron për arsye se nuk kemi të bëjmë me cenimin e statusit profesional të gjyqtarit ose të zyrtarit të veçantë të administratës gjyqësore siç e parashikon neni 63/1 i ligjit “Për qeverisjen e gjyqësorit”. Megjithatë, ne si Komision e patëm përgatitur projekt-atin në dy variante dhe menduam që mos ta gërshetojmë projektvendimin me rregulloren. Se çfarë meraku kishim ne?

Ne kishim merakun vetëm në një rast. Mirë kur është rasti i arkivimit të ankesave, po në rastet nëse vendimi i pushimit të hetimit do të ishte i padrejtë, çfarë do bënte? Dhe menduam që më mirë, treshja e anëtarëve që do të jetë, ta përcaktojmë vetë me anë të një rregulloreje. Kjo ishte ideja.

Naureda Llagami: Atëherë, a mendoni që të shtojmë një pikë që të themi që Komisioni të miratojë disa rregulla. E shtojmë një pikë në fund të projekt-aktit apo si e vlerësoni?

Atëherë, unë do sugjeroja që përpara pikës 11 të projekt-aktit të shënohet që Komisioni miraton rregulla lidhur me veprimtarinë e tij.

Ndonjë sugjerim apo koment tjetër ju lutem?

(Një nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Faqja e dytë? E relacionit?

Po mirë, atë po. E mbajmë parasysht në zbardhje.

E kalojmë në votim bashkë me...

Brunilda Kadi: A është menduar se çfarë do ndodhë nëse ju prishni vendimin e Kryeinspektorit? Çfarë ndodh?

Jo, po s’mund ta vesh tek rregullorja. Është tek vendimi çfarë bëhet në këtë rast.

Medi Bici: Do ta vendosim tek rregullat.

Brunilda Kadi: Është çështje principi ajo, s’mund ta vendosësh në rregullore.

Medi Bici: Si e kishim idenë ne. Ju nuk e keni variantin e dytë, se e lamë për ta bërë rregullore.

Në rastin kur Komisioni i Përkohshëm pranon ankimin, pra rrëzon vendimin e dhënë nga Kryeinspektori i ish-KLD, njoftohen palët dhe çështja regjistrohet në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim, në pritje për t'i kaluar hetimeve të mëtejshme Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, menjëherë sapo të ngrihet ky institucion. Prandaj e lamë që të bëhet me rregullore. Se kishim diskutime për këtë. Kemi variantin e parë, prandaj thamë të jetë pjesë e rregullores.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

S'jemi tek rregullorja. E lamë që do të bëjmë rregullore.

Naureda Llagami: Atëherë, ta kalojmë për miratim projekt-aktin së bashku me propozimin të pranuar edhe nga Komisioni përkatës lidhur me detyrimin që ka ky Komision për të miratuar rregulla për ushtrimin e veprimtarisë së tij? Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Tani, në zbatim të këtij vendimi, unë do ftoja edhe stafin që të na mundësojë hedhjen e goglave për përcaktimin e anëtarëve përbërës të këtij Komisioni, ku parashikohet që dy nga anëtarët do jenë nga anëtarët jo gjyqtarë dhe një anëtar do jetë gjyqtar.

Elis Kuçi: Atëherë, së pari do zgjidhen nga 4 anëtarët jo gjyqtarë, do zgjidhen 2. Ne kemi 4 fletë, ku dy fleta janë shkruar “jo anëtar” dhe dy fleta janë shkruar “anëtar”. Gjithsecili nga anëtarët do tërheqë një gogël. Për transparencë...

(Nga administrata e Këshillit shiritat e lartpërmendura citohen me zë dhe futen në goglat respektive.)

1. Jo anëtar i Komisionit. *(Shiriti futet në gogël)*

2. Jo anëtar i Komisionit. *(Shiriti futet në gogël)*

3. Anëtar i Komisionit. *(Shiriti futet në gogël)*

4. Anëtar i Komisionit. *(Shiriti futet në gogël)*

(I pari që përzgjedh është zoti Maksim Qoku.)

Maksim Qoku: Jo anëtar i Komisionit.

(I dyti që përzgjedh është zoti Erjon Muharremaj.)

Erjon Muharremaj: Jo anëtar i Komisionit.

(I treti që përzgjedh është zoti Alban Toro.)

Alban Toro: Anëtar i Komisionit.

(E katërta që përzgjedh është zonja Fatmira Luli dhe gogla e mbetur është “anëtar i Komisionit”).

Naureda Llagami: Atëherë, anëtarë të Komisionit “Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimit të hetimit ndaj një gjyqtari” janë përzgjedhur me short dy anëtarët jo gjyqtarë zonja Fatmira Luli dhe zoti Alban Toro.

Kalojmë në hedhjen e shortit për anëtarin gjyqtar.

Elis Kuçi: Nga 6 anëtarët, do zgjidhet vetëm 1 anëtar.

(Përsëritet e njëjta procedurë si më sipër, futen shiritat në gogla, për t’u përzgjedhur më pas nga 6 anëtarët gjyqtarë të Këshillit.)

(I pari që përzgjedh është zoti Medi Bici.)

Elis Kuçi: Jo anëtar i Komisionit.

(E dyta që përzgjedh është zonja Brunilda Kadi.)

Brunilda Kadi: Jo anëtar.

(I treti që përzgjedh është zoti Dritan Hallunaj.)

Dritan Hallunaj: Anëtar i Komisionit.

Elis Kuçi: Të tjerat i hapim për transparencë.

Naureda Llagami: Atëherë, në cilësinë e Kryetares së Këshillit, propozoj zotin Toro për kryetar të Komisionit.

Atëherë, nga ana e gjyqësorit u zgjodh zoti Dritan Hallunaj, anëtar i Komisionit.

Nëse nuk keni çështje të tjera për të diskutuar, unë e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Kisha edhe diçka tjetër për të komunikuar, mbledhja e radhës do jetë ditën e martë, për shkak të angazhimit që kemi të enjten dhe të premtën. Jemi në pamundësi që ta zhvillojmë ditën e enjte mbledhjen. Lidhur me orarin se kur do jetë ditën e martë, unë do t'ju informoj sepse varet shumë edhe nga axhenda që do kemi për shkak të Komisionit të Ligjeve, i cili mund të na kërkojë që të jemi pjesëmarrës për prezantimin e projektbuxhetit tonë atje. Kështu që, lidhur me orën, kjo do jetë fleksibël në varësi të informacionit që do vijë nga Komisioni i Ligjeve. Dakord?

Mirupafshim!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor